

PROF. KASTRIOT MISJA – BABAI I ENTOMOLOGJISË SHQIPTARE

(1933 –2022)

ALEKO MIHO, FERDINAND BEGO

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Biologjisë,

Në 25 Shkurt 2022 u nda prej nesh Prof. Kastriot Misja, themelues i shkencës së entomologjisë shqiptare, një koleg sa i formuar në profesion aq dhe i njerëzishëm në gjithë marrëdhëniet tona, një qytetar dhe familjar i shkëlqyer.

Prof. Misja u lind në Elbasan, më 13 shkurt 1933. Studimet e larta i kreu pranë Fakultetit të Biologjisë, Universiteti i Moskës ‘Lomonosov’, Rusi, në periudhën 1953-1958. Pas kthimit në atdhe, ka punuar për 10 vite si mësues i Biologjisë dhe Kimisë në Shkollat Pedagogjike, në Vlorë dhe në Elbasan. Në 1968 emërohet punonjës shkencor-



mësues pranë Muzeut të Shkencave të Natyrës (MShN), në atë kohë pranë Katedrës së Zoologjisë, sot pjesë e Qendrës së Kërkimit të Florës dhe Faunës (QKFF), po pranë FShN, UT; këtu ai punoi gjatë gjithë karrierës deri sa doli në pension në vitin 2000; madje për periudhën 1990-1999 ka qenë qenë edhe Përgjegjës i Muzeut.

Në vitin 1979, Prof. Misja fiton gradën ‘Kandidat i Shkencave’ duke mbrojtur punimin për fluturat e natës në Shqipëri (familja Noctuidae). Në 1993 fiton gradën ‘Doktor i Shkencave’, me punimin mbi fluturat e grupit Macrolepidoptera, veçanërisht për të dhëna bioekologjike të llojeve të dëmshme. Në vitin 1985 i jepet titulli ‘Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor’ (Docent), kurse në vitin 1994 i jepet titulli ‘Profesor’. Përveç diplomimit në Moskë, Profesori ka kryer gjatë karrierës disa specializime jashtë shtetit: në Muzeun e Historisë së Natyrës, Kalimero, Lecce, Itali; në Universitetin VI ‘Pierre & Marie Curie’, për

përcaktimin gjenetik të insekteve dhe pranë Muzeut të Historisë Natyrës, në Paris, Francë, për grupin Microlepidoptera.

Prof. Misja mund të quhet me të vërtetë babai i entomologjisë shqiptare. Bashkëpunëtorët dhe studentët e njohin si kërkues shumë të aftë, serioz dhe të përkushtuar, si në punën në terren, në kabinet, në veprimtarinë botuese, por dhe në mësimdhënie dhe mbrojtje mjedisi. Fusha e entomologjisë nuk është fort e lehtë, sidomos për realitetin shqiptar, për terrenin e thyer kodrinor, malor, për vetë sjelljen e fluturave (ditën dhe natën), por dhe për përvojën e munguar në këtë fushë. Pra, studimet entomologjike përbënin një sfidë, duke filluar nga puna në terren për ndjekjen dhe grumbullimin e llojeve, ruajtjen dhe transportin e koleksionit, dhe sidomos përpunimin në kabinet, pranë MShN, për përcaktimin e llojeve, gjetjen e literaturës përkatëse, si dhe sistemimin, ekspozimin dhe ruajtjen e koleksionit shkencor në Muze. Vlen të përmendet këtu kontributi i paçmuar i Profesorit në mbrojtjen, ruajtjen dhe pasurimin e materialeve entomologjike të Muzeut; pjesa më e madhe e Fondit Shkencor të entomofaunës pranë MShN, ka pa diskutim vulën e Prof. Misjes.

Qysh në fillimin e karrierës, Prof. Misja ka kryer qindra ditë ekspedita në gjithë zonat klimatike të Shqipërisë (1968-1999); si rrjedhojë, janë zbuluar prej tij mbi 1200 lloje insektesh (hemipterë dhe lepidopterë), shumica e tyre për herë të parë për Shqipërinë; këto kanë hedhur themelet dhe kanë pasuruar me disa dhjetra mijra ekzemplarë Fondin Shkencor të Entomofaunës Shqiptare pranë MShN. Gjatë periudhës 1968-1971 ka studjuar rendin Hemiptera (gjysmëflatrafortët): për këtë rend janë përcaktuar 220 lloje. Më pas, gjatë periudhës 1972-2005, vazhdon me studimin e rendit Lepidoptera (fluturat), ku janë përcaktuar rreth 800 lloje për Shqipërinë. E gjithë kjo veprimtari është kryer edhe duke i kushtuar kujdes punës me të rinjtë, studentë dhe doktorantë, për të cilët Prof. Misja ka qenë i papërtuar. Në këtë mënyrë, prej tij janë udhëhequr 8 doktorantë, dhe 5 studentë për punë diplome në Shkollën Pasuniversitare (SHPU) ose master, nga vendi dhe diaspora, disa prej tyre vazhdojnë ende me dinjitet kërkimin në drejtime të ndryshme entomologjike. Bashkëpunëtorët edhe sot pohojnë se asnjë lloj nuk mund të konsiderohej si i tillë pa çertifikimin e saktësisë nga Prof. Misja; vetëm kur ai thoshte 'po' konsiderohej punë e mbaruar në përcaktimin shkencor të llojit.

Veprimtaria botuese e Profesorit, si autor i vetëm ose me bashkëautorësi, është e gjerë, e larmishme, e shtrirë brenda dhe jashtë vendit, me 15 tekste mësimorë, 2 monografi, 19 artikuj shkencorë, 2 botime me karakter mjedisor, 2 botime me karakter popullor, 4 kumtesa, 15 referime shkencore dhe shumë artikuj me karakter popullor. Monografia '*Fluturat e Ditës (Rhopalocera) të Shqipërisë*', është botuar nga Akademia e Shkencave në 2005; ndërkohë Prof. Misja ka përgatitur gati për botim edhe monografinë tjetër për grupin Bombyces dhe Sphinges (Lepid. - Heterocera), pra '*Fluturat Heterocera të Shqipërisë*'; për fat të

keq kjo ende nuk e ka gjetur rrugën e botimit; do këshillojm bashëpunëtorët që të bien në kontakt me këtë dorëshkrim dhe të ndihmojnë për botimin. Edhe ky punim do ishte jo vetëm ndihmë për ekspertët e fushës, por dhe një dëshirë e munguar e Profesorit; shpesh gjetje të tilla janë të papërsëritshme!



Profesor Misja (i treti në qendër) gjatë punës në terren, në Alpet Shqiptare, me kolegë dhe studentë nga Universiteti i Tiranës dhe i Shkodrës, nga e majta Prof. S. Beqiraj, Olgër Molla, Prof. L. Kashta, Prof. Rr. Smajlaj.

Artikujt shkencorë japin të dhëna mbi grupe të ndryshme insektesh, kryesisht flutura nga vise të ndryshme shqiptare, dhe konkretisht: në Buletinin tonë të Shkencave të Natyrës (BShN) ka publikime për: Hemipterët (1970; 1973); fluturat e natës të familjeve Noctuidae (1976), Geometridae (1977) dhe Noctuidae (1981); grupin Heteroneura (1978); fluturat e ditës (1984); grupin e molave Microlepidoptera (1987; 1990). Gjithashtu, publikime të tjera janë: entomofauna e Shqipërisë dhe probleme të ruajtjes së mjedisit (Buletini i Konferencës Kombëtare për Mjedisin, 1981); insektet gjysmëflatrafortë, dëmtues të kulturave bujqësore (Buletini i Konferencës Kombëtare të Bujqësisë, 1975); larmia biologjike dhe klasifikimi i botës shtazore (Biologjia në Shkollë, 1986); një shfaqje e pazakontë e fluturës *Didymaeformia didyma* (Alexanor,

1989); gjetja për herë të parë e fluturës *Danaus chrysippus* në Shqipëri (Alexanor, 1989), Paris, Francë; analizë faunistike e lepidopterëve të ditës në Shqipëri (Gallo-Hellenica, 1993); kontribut në njohjen e lepidopterëve të Shqipërisë (Nota Lepidopterologica, 1993); analizë e mëtejshme e fluturës *Maniola jurtina* në Shqipëri (Nota Lepidopterologica, 1993); kontribut për fluturat e kërcënuara të Europës (Red Data Book of European Butterflies, 1997-98); njohja e zonave në përparësi për fluturat e Europës (Identifying Prime Butterfly Areas in Europe - National compilers, 2001).

Nga kumtesat e botuara mund të përmendim: Insektet gjysmëflatrafortë, dëmtues të kulturave bujqësore, mbajtur në Konferencën e I-rë Kombëtare të Bujqësisë (1975); Entomofauna e Shqipërisë dhe problemet e ruajtjes së mjedisit, në Konferencën e I-rë Kombëtare për Mjedisin (1981); L'analyse faunistique des Lepidopteres Diurna de l'Albanie, mbajtur në '5e Congres International sur la Zoogeographie et Ecologie de la Greece et des Regions Avoisnantes', Iraclion, Greqi (1993); Expose sur problemes de l'education l'environnement en Albanie, në 'Workshop on education and training in Environnement and Devolopment', Barcelonë (1992).

Prof. Misja ka punuar gjërësisht si anëtar i grupeve të punës në projekte studimore të rëndësishme, disa dhe të Bankës Botërore, si: Strategjia për ruajtjen e mbrojtjen e mjedisit (1994-1995); Projekti për lagunën e Karavastasë (1996 - Phare Services); Pyjet e Virgjër të Shqipërisë (Vëzhgim Ekologjik – 1995-1997); Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin (1997-1999); Studimi i Zonave të Mbrojtura (1998-2000); Studimi i Biodiversitetit të Pyjeve për Menaxhim (2000-2001); Vlerësimi i gjendjes të Biodiversitetit në zonat: Llogara, Karaburun, Sazan, Orikum, Nartë (2000-2001); Vlerësimi i Biodiversitetit në gadishullin e Ksamilit (2000). Në projekte studimore ndërkombëtare, si: Red Data Book of European Butterflies (National Compilers) (1997-1999), Council of Europe; Identifying Prime Butterfly Areas in Europe (National Compilers) (2001), Dutch Ministry of Agriculture. Ka qenë drejtues i projektit për hartimin e Librit të Kuq të Florës dhe të Faunës Shqiptare (Electronic database) (2003-2005) financuar nga GEF, etj. Gjithashtu, ka qenë konsulent në disa projekte të GEF, në vitet 1999-2002, si: Biodiversiteti i Liqenit të Shkodrës; Ne dhe Mjedi, Ardenicë; Parku Kombëtar i Thethit; Rreqebulli, specie e rrezikuar; Liqeni i Shkodrës; Nyja Ekoturistike Pylli i Bedenit – Plazhi i Gjeneralit; etj.

Edhe veprimtaria mësimore e Prof. Misjes ka qenë shumë aktive. E fillon karrierën si mësues i lëndës së Biologjisë në gjimnaz për 10 vite (1958-1968). Më pas, për 25 vite, ai ka qenë titullar, hartues programesh dhe drejtues laboratorësh apo praktikash (pedagogjike dhe në terren) për lëndët: Metodikë e Mësimdhënies në Biologji, me studentët e degës së Biologji-Kimisë në FShN; Entomologji e Përgjithshme, në degën 5-vjeçare të Biologjisë; Zoogeografi në

Shkollën Pasuniversitare (ShPU) të Biologjisë Shtazore, pranë Departamentit të Biologjisë (DB), FShN, dhe Masterin Profesional të Mësuesisë së Biologjisë, DB, FShN. Gjithashtu, ka ligjëruar një cikël leksionesh në Entomologji në kursin pasuniversitar të Mbrojtjes së Bimëve, pranë Fakultetit të Agronomisë, në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Gjatë kësaj veprimtarie është marrë me përmirësimin e Planit Mësimor të degës së Biologjisë, FSHN dhe me hartimin e Planit Mësimor të degës së Biologjisë 5-vjeçare, pranë DB, FShN. Deri në daljen në pension, ka qenë pjesmarrës në grupe të ndryshme pune për planet dhe programet mësimore të degës Biologji-Kimi; anëtar i komisioneve të Provimeve të Shtetit dhe të Mbrojtjes së Diplomave. Në gjithë këtë karrierë ka udhëhequr mbi 30 punë diplomash në mësimdhënien e Biologjisë dhe në Entomologji. Për disa vite ka qenë i përfshirë dhe në kualifikimin pasuniversitar të mësuesve të Biologjisë. Ka qenë Kryetar i Këshillit Shkencor të degës së Biologjisë; anëtar i Këshillit Shkencor të FShN; anëtar i Komisionit të Mbrojtjes së Disertacioneve dhe për Shkollën Pasuniversitare, FShN. Ka qenë oponent i shumë disertacioneve, teksteve mësimore, i disa diplomave, si dhe reçenzent i shumë artikujve shkencorë.

Prof. Misja është autor/bashkëautor në 15 tekste mësimore: Zoologjia për Shkollat Pedagogjike (1973); Përcaktuesh insektesh – Hemiptera (1973), Coleoptera (1974), Lepidoptera (1978); Metodika e Biologjisë (e përmirësuar) (1984); Entomologjia (Leksione të Shkruara) (1985); Praktika Verore me ilustrime (1987); Udhëheqës i Praktikave në Terren (1999); Metodika e mësimdhënies në ‘Dituri Natyre’ (2001); Metodika e Mësimdhënies së Biologjisë (2005); Entomologjia (për degën 5-vjeçare) (2002); Zoogjeografia (2010); Biologjia dhe Edukimi Shëndetësor 8 (2012); Udhëheqës terreni (2013); etj. Është autor për disa zëra të faunës në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar (1985).

Prof. Misja nuk ka reshtur deri në fund të jetës për popullarizimin e shkencës, duke botuar libra dhe artikuj, duke filluar nga revista ‘Shkenca dhe Jeta’, dhe më pas te ‘Horizonti’, ‘Mrekullia’ etj.; p.sh. ‘Ç’dimë e ç’nuk dimë’ (1991); ‘Enigmat e shtegtimeve (përkthyer e përshtatur) (1992).. Mbrojtja e mjedisit ka qenë gjithmonë nën vëmendje, ku spikat kontributi në botimet: Libri i Kuq i Faunës Shqiptare (për shkollarët) (1998) dhe i ripunuar (2001); Libri i Kuq i Faunës Shqiptare (gjithë fauna shqiptare) (2006), ende në përdorim, dhe bazë për Listën e Kuqe të Faunës së Shqipërisë (2013) ende në përdorim. Prof. Misja ka qenë për shumë vite Kryetar i Shoqatës së Biologëve të Shqipërisë (1991-2000). Për veprimtarinë e tij shkencore-mësimore është dekoruar me Urdhërin ‘Naim Frashëri’, Klasi i III-të (1980); është vlerësuar për punën e mirë 3-vjeçare në Bordin e Komitetit Drejtues Kombëtar të GEF- Small Grants Programme, të Global Environment Facility (GEF), United Nations Development Programme (UNDP), United Nations Volunteers (UNV).

Vlen të theksojmë se Prof. Misja e drejtoi MShN në një periudhë shumë të vështirë të tranzicionit shqiptar (1990-1999), plot trazira, plot mungesa në mbështetje për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e Fondit Shkencor, por edhe plot kërcënim për vetë ndërtesën në Rrugën e Kavajës, Tiranë; përpjekjet e Profesorit dhe e kolegëve të tjerë që pasuan qenë shumë të mëdha për të mos e lëvizur Muzeun nga ai vend; aty MShN kishte hapësirë prej rreth 4500 m² dhe vendndodhje, shumë të volitshme për një Institucion të tillë. Më pas, me shumë përpjekje, madje korruptive, Muzeu përfundoi i rrudhur shumë në hapësirë (rreth 1500 m²) dhe në një zonë tepër të humbur të qytetit (Rruga Todi Shkurti, te ish Tregu Elektrik); e gjitha kjo në emër të ish pronarëve për të ndërtuar dy kulla të larta pa ndonjë funksion të mirëfilltë! Në këtë transferim, Muzeu humbi një pjesë të mirë të fondit të Ksilotekës, si dhe nuk dihet se ku përfundoi i gjithë fondi shkencor i Mineralogjisë. Kjo nëpërkëmbie që ju bë MShN ishte edhe një zhgënjim dhe dëshirë e pa realizuar e Prof. Misjes.

Prof. Kastrioti do të kujtohet gjithmonë si shkencëtar i formuar, shumë i përkushtuar në terren dhe në kabinet, gjithmonë i gjendur për kolegët dhe studentët. Vepra e tij është gur themeli për entomologjinë shqiptare dhe burim frymëzimi për gjithë brezat sot dhe në të ardhmen.